



KONTROLLI I LARTE I SHETIT K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 224-332

Nr. 414/6 Prot.

Tiranë, më 21.07.2016

V E N D I M

Nr. 96, Datë 21.07.2016

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË BASHKINË FUSHË ARRËZ "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", të ushtruar në Bashkinë Fushë Arrëz, për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 31.12.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk janë zbatuar rekomandimet e lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH, për 18 masa organizative me mungesë të ardhurash në vlerën **9,463,410 lekë** dhe 2 masa shpërbllim dëmi me vlerë **418,366 lekë**, veprim në kundërshtim me nenet 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, të marrë në analizë situatën e zbatimit të shkresës nr. 497, datë 04.07.2013 "Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH në auditimin e mëparshëm", të dalin përgjegjësitë individuale dhe institucionale për mos vlerësim dhe zbatim të masave të rekomanduara nga KLSH, si dhe të hartohet plan-veprimi specifik për vlerësimin sipas

afateve administrative për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH me shkresë nr. 349/6, datë 21.06.2013.

Brenda muajit Gusht 2016

2. Gjetje nga auditimi: Nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Konkretisht nuk është caktuar koordinatori i riskut, nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij, nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, nuk janë miratuar gjurmët për auditim, nuk është hapur regjistri i riskut ku të regjistrohen raportimet dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive, veprim në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të vlerësojë shkeljet e konstatuara të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe të marrë masat e nevojshme për implementimin e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është miratuar struktura e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) dhe nuk është lidhur aktmarrëveshje me IKMT Dega Shkodër, në zbatim të neneve 4, 6 dhe 18, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar, për delegim kompetencash.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, të propozojë për miratim strukturën e Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV), ose në mungesë personeli të kualifikuar të lidhë aktmarrëveshje me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT), Dega Shkodër.

Brenda muajit Shtator 2016

4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Fushë Arrëz dhe ish-Komunat Qafë Mali, Iballë, Blerim dhe Fierzë, kanë funksionuar pa një rregullore të brendshme me detyra përkatëse për çdo sektor dhe punonjës. Nuk ka funksionuar sektori i administrimit të pronave, si dhe nuk janë ngritur grupe pune për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin e pronave në ZVRPP Pukë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, të hartojë dhe miratojë Rregulloren e Brendshme të funksionimit të strukturave të bashkisë, duke përcaktuar detyrat për çdo sektor dhe punonjës. Të miratojë strukturën e pronave publike dhe menaxhimit të aseteve, grupet e punës për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm dhe të nevojshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar, me qëllim vlerësimin paraprak dhe regjistrimet në kontabilitet dhe ZVRPP Pukë.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz dhe ish-Komunat Qafë Mali dhe Iballë, u konstatua se **5 subjekte** shfrytëzojnë sipërfaqe pyjore dhe kollusore në pronësi/përdorim të këtyre njësiteve vendore të miratuar me VKM, gjithsej **556.1 ha**. Këto subjekte nuk kanë bërë të mundur lidhjen e kontratave për sipërfaqet që ato kanë në përdorim, me qëllim përlllogaritjen dhe pagesën e qirasë, duke sjellë mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetet e tyre për vlerën **163,005,600 lekë**, veprime në kundërshtim me germën “q” e nenit 38, pikat 1 dhe 2 e nenit 40/1, të ligjit nr. 9791, datë 23.07.2007 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar me ligjin nr. 9533, datë 15.05.2006, pikat 4, 6 dhe 11, të

VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal”, si dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja 2.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Qafë Mali, Iballë dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Fushë Arrëz, të marrë masa për ngritjen e një grupi punë me specialist të fushës, për evidentimin dhe saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme në pyjeve dhe kullota, duke lidhur kontrata ligjore para noterit publik, në përputhje me germën “f” të nenit 39 dhe nenet 40, 54, 56, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, si dhe pikat 3, 4 dhe 7, të Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, të ndryshuar, duke përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për qiranë në vlerën **163,005,600 lekë**, *respektivisht:*

-Shoqëria “**■**” për sipërfaqen 55 ha (zona Munell), me vlerë **48,400,000 lekë**, sipërfaqen 298 ha (zona Lak Roshi), me vlerë **55,428,000 lekë**, sipërfaqe 78 ha (zona Qaf Bari), me vlerë **9,672,000 lekë**, sipërfaqe 88.4 ha (zona Tuç), me vlerë **10,961,600 lekë**.

-Shoqëria “**■**” për sipërfaqen 8.8 ha (zona Shtraz 1 dhe Shtraz 2), me vlerë **11,616,000 lekë**.

-Shoqëria “**■**” për sipërfaqen 28.6 ha (zona Race), me vlerë **25,168,000 lekë**.

-Shoqëria “**■**” për sipërfaqen 2 ha (zona Iball), me vlerën **1,760,000 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz, u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullor, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

6.1. Rekomandimi: Struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në Bashkinë Fushë Arrëz, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjorë dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kullor.

Brenda muajit Shtator 2016

7. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është miratuar Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planit të Detajuar Vendor, veprime në kundërshtim me nenin 40, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Zyra e Planifikimit Territorit Urban, të marrë masa për hartimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak dhe më pas në KKT, Instrumentin e Përgjithshëm Ndërvendor dhe Planit të Detajuar Vendor dhe më pas të vijojnë procedurat për dhënien e lejeve të shfrytëzimit dhe përdorimit për objektet private dhe punë publike.

Brenda muajit Shtator 2016

8. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz dhe ish-Komunat Iballë, Blerim, Qafë Mali dhe Fierzë, në lidhje me administrimin e taksave dhe tarifave vendore, u konstatua mangësitë e mëposhtme:

-Mungesa e regjistrimit dhe kartelave personale të subjekteve fizik, juridik, institucionet shtetërore dhe abonentëve familjarë, për evidentimin e detyrimit që ato kanë dhe vlerën e detyrimit të

mbetur, veprime në kundërshtim me pikën 7 e nenit 3, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

-Mos njoftimi i abonentëve familjarë për detyrimet që ato kanë për taksat e tarifave vendore, mbi evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, sa kanë paguar dhe sa mbeten për pagesë, veprime në kundërshtim me nenet 10, 12, 13 dhe 15, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

8.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për;

-hapjen e kartelave individuale të subjekteve fizik, juridik, institucionet shtetërore dhe abonentët familjarë, duke i grupuar sipas llojit të taksave dhe tarifave.

-hartimin e planit vjetor për ushtrimin e kontrolleve sipas drejtimeve të përcaktuar në ligj.

-hartimin e regjistrit themelor të subjekteve fizik, juridik, institucioneve shtetërore dhe abonentët familjarë për taksat e tarifave vendore, duke evidentuar detyrimet fiskale.

-njoftimin e të gjithë abonentëve familjarë për detyrimet për taksat e tarifave vendore, duke shfrytëzuar si agjent tatimor Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime.

Brenda muajit Shtator 2016

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz dhe ish-Komunën Qafë Mali, u konstatua se në fund të vitit 2015 janë **120 subjekte** debitorë (juridik dhe fizik), me vlerë **5,107,604 lekë**, nga e cila; Bashkia Fushë Arrëz në vlerën 1,357,100 lekë dhe ish-Komuna Qafë Mali në vlerën 3,750,504 lekë, vlerë e cila nga njëra periudhë në tjetrën ka ardhur në rritje, si në numër dhe vlerë.

Për vjeljen e këtyre debitorëve, zyra e taksave vendore nuk ka ndjekur procedurat në zbatim të nenit 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreun i XI, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

9.1. Rekomandimi: Për arkëtimin e detyrimeve tatimore të **120 subjekte** debitor me vlerë **5,107,604 lekë**, bazuar në pikën 3 e nenit 70, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **të nxirren njoftim vlerësimet tatimore**, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të llogariten kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë).

-Në rast se bizneset private edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 04.12.2014 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të vendosen masa administrative e të bëhet kallëzim penal.

Brenda muajit Shtator 2016

10. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz, u konstatua se taksa e ndërtesës aplikohet me vlerë fikse (400 lekë/vit), veprim në kundërshtim me nenin 22, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar (lekë/m²/vit).

10.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Juristin e Bashkisë Fushë Arrëz, në miratimin e paketës fiskale të vitit 2017, taksa e ndërtesës të aplikohet sipas nenit 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, i ndryshuar, duke përcaktuar për çdo objekt tarifën lekë/m²/vit, sipas destinacionit dhe jo taksë fikse.

Me miratimin e paketës fiskale të vitit 2017, nga Këshilli Bashkiak

11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz, nuk është bërë i mundur kontrolli dhe arkëtimi i të ardhurave nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hotelierisë, veprime në kundërshtim me nenet 4, 26 dhe 32, të ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurën Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurave dhe të raportimit të sistemit të Taksave Vendore.

Nga të dhënave e regjistrit të subjekteve, rezulton se me aktivitet hotelierie janë 3 subjekte, *respektivisht*; “████████”, “████████” dhe “████████”, të cilët nuk kanë paguar asnjë detyrim dhe nuk është ushtruar asnjë kontroll për të ardhurat e realizuar nga ky aktivitet.

11.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të evidentojë, të saktësojë, të llogarisë dhe të arkëtojë detyrimet që rrjedhin nga aktiviteti i hotelierisë të subjekteve “████████”, “████████” dhe “████████”, duke kryer kontrole periodike të dokumentuara në çdo subjekt.

Brenda muajit Gusht 2016

12. Gjetje nga auditimi: Policia Bashkiake, nuk ka hartuar planet e shërbimit në zbatim të detyrave të ngarkuara, si dhe nuk ka dokumentacion ligjor për evidentimin e kontroleve të kryera në terren, veprime në kundërshtim ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, si dhe urdhrin e përbashkët e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003” dhe Ministrit të Rendit Publik nr. 823, datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores “TIP” të policisë bashkiake dhe të Komunës”.

Emërimi i inspektorëve të Policisë Bashkiake, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 3 dhe 4, të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë”, i ndryshuar.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për emërimin e inspektorëve të Policisë Bashkiake në përputhje me aktet ligjore, duke u përqendruar në arsimin përkatës (Akademinë e Policisë). Për hartimin e planeve të shërbimit në zbatim të detyrave të ngarkuara, të evidentohet kontrollat e kryera me raport shërbimi.

Brenda muajit Shtator 2016

13. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz ka munguar ngritja e një strukture funksionale në Zyrën e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, strukturë e cila ka qenë e pa plotësuar e reduktuar, jo funksionale e paqëndrueshme dhe që nuk i është përgjigjur përmbushjes së detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit, zhvillimit e kontrollit të territorit dhe nevojave që kërkon administrimi ligjor i territorit të kësaj Bashkie.

Kjo strukturë e pa plotësuar si në numër dhe me mungesa të theksuara kapacitetesh profesionale, është në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i shfuqizuar dhe ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, me pasojë keq menaxhimin e territorit me dëme e mungesë të ardhurash për buxhetin e komunës dhe me mungesë të kontrollit të territorit.

13. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa të plotësojë strukturën funksionale të Planifikimit dhe Zhvillimit e Kontrollit të Territorit, sipas kërkesave ligjore me synim menaxhimin e territorit, eliminimin e dëmeve dhe mungesës të ardhurave, si dhe ushtrimin e administrimit dhe kontrollit të territorit.

Brenda muajit Gusht 2016

14. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz, në zbatim të urdhrin nr. 28, datë 13.08.2015 të Kryetarit të Bashkisë, nuk ka përfunduar procesi i depozitimit të dokumentacionit ligjor në lidhje me transferimin e arkivave (dokumenteve) dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-Komunat, veprime në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekur nga riorganizimi administrativo-territorial”.

14.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për përfundimin e procesit të depozitimit të dokumentacionit ligjor, mbi transferimin e arkivave dhe pasurive të luajtshme dhe paluajtshme që kanë në administrim ish-Komunat.

Brenda muajit Korrik 2016

15. Gjetje nga auditimi: Në dokumentacionin e audituar mbi mënyrën e dokumentimit të përdorimit të karburantit në Bashkinë Fushë Arrëz dhe ish-Komunat Qafë Mali dhe Fierzë, u konstatua se nuk është miratuar me specialist të fushës normativat e harxhimit të karburantit, për mjetet e transporti dhe 2 kaldajat (kopshti dhe bashkia), duke mos bërë të mundur planifikimin e saktë të nevojave për këtë artikull.

15.1. Rekomandimi: Zyra e Shërbimeve Publike në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa që me grup pune me specialist të fushës, të llogarisë normativat e harxhimit të karburantit për mjetet e transportit dhe 2 kaldajat.

Brenda muajit Gusht 2016

16. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz për vitin 2014, teprica e llogarisë 213 paraqitet për vlerën 96,312,413 lekë, ndërkohë që në listën e inventarit bashkëlidhur paraqitet në vlerën 123,284,922 lekë, me mosrakordim për vlerën 26,972,509 lekë. Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, në fund të vitit 2012 paraqitet me gjendje në vlerën 3,098,785 lekë dhe në fund të vitit 2013 gjendja arrin në vlerën 4,162,785 lekë ose me rritje për vlerën 1,064,000 lekë, ndërsa në fund të vitit 2014 kjo gjendje arrin në vlerën 4,162,785 lekë, e pa ndryshuar.

Nga krahasimin i bërë ndërmjet vlerës së paraqitur në bilanc dhe gjendjes së inventarit, u konstatua mosrakordim në vlerën 609,700 lekë (më e madhe se inventari). Në listën e inventarit të gjendjes së llogarisë 218 “Inventar ekonomik”, rezulton vlera 3,553,085 lekë, krahasuar me gjendjen e bilancit më 31.12.2014, kjo diferencë rritet dhe arrin në vlerën 751,400 lekë.

16.1 Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa për saktësimin e diferencave midis gjendjes së inventarit dhe llogarive në pasqyrat financiare, duke bërë analizë të inventarëve të paraqitur në listat përkatëse dhe pasi të bëhet saktësimi dhe sistemi në kontabilitet, ndryshimet të reflektohem në pasqyrat financiare në pasqyrat financiare të vitit 2015, i cili akoma nuk është mbyllur.

Brenda muajit Gusht 2016

17. Gjetje nga auditimi : Në pasqyrat financiare të vitit 2013, u konstatua se llogaria 202 “Studime e Kërkime”, është e pa rakorduar me inventarët në vlerën -1,049.600 lekë.

Llogaritë 210-219, sipas listës së inventarëve rezultuan në vlerën 69,561,524 lekë, ndërsa në pasqyrat financiare kjo llogari paraqitet në vlerën 165,580,469 lekë, më pak për vlerën 96,018,945 lekë. Llogaritë 423- 429, paraqitet me tepriçë debitor në vlerën 72,382 lekë, e pa analizuar dhe trashëguar ndër vite. Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, rezulton me tepriçë debitor në vlerën 1,644,742 lekë, e pa analizuar dhe pa shpjegime për origjinën. Llogaria 215 “Mjete transporti”, në pasqyrat financiare në pasqyrat financiare paraqitet në vlerën 1,167,285 lekë, ndërsa sipas inventarit paraqitet në vlerën 1,194,500 lekë, pra më tepër për vlerën 27,215 lekë, veprime në kundërshtim me pikën 12/a, të standardit nr. 5 dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

17.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa për sistemimin e vlerës **1,049,600 lekë**, të pozicionuar në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”, në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara të përfunduara, si dhe të analizohet statusi i projekteve për diferencën e vlerës gjendje.

Brenda muajit Gusht 2016

18. Gjetje nga auditimi: Në tenderat e prokurimeve publike të ish-Komunave Qafë Mali, Fierzë, Blerim, Iball, dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë të inventarizuar dhe arkivuar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe aktet ligjore në zbatim të tij.

18.1 Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit të punimeve/shërbimeve, të kryera në ish-Komunën Iballë, Blerim, Qafë Mali dhe Fierzë.

Brenda muajit Gusht 2016

19. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste të prokurimeve me procedurën e tenderimit, mungon dokumentacioni i nevojshëm për mënyrën e llogaritjes së fondit limit, veprime në kundërshtim me kërkesat Kreut VI, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

19.1. Rekomandimi: Në të gjitha rastet e prokurimeve, njësia e prokurimit të mos fillojë procedurat e prokurimit, pa siguruar më parë nga zyrat përkatëse, dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ekonomik, si preventiva, projekte skica dhe çdo dokumentacion tjetër argumentues për sasishtë në rastet e blerjeve dhe çmimeve të llogaritjes së fondit limit.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa V, kreu I “Akti administrativ”, nenet 98-102, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 21-33 “Funksionimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 608-628 në vijim, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej

regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 75,765,200 lekë, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë Arrëz, u konstatua se me VKM nr. 864, datë 10.12.2014 “Për heqjen nga fondi pyjor dhe kollusor të sipërfaqeve në ekonomitë pyjore “Kryezi-Bicaj dhe Munellë”, Qarku Shkodër, që do të përdoren nga shoqëria “█████” sha, për aktivitetin mineral dhe depozitim sterilesh”, sipërfaqja prej 12.5 ha (0.125 km²) është kaluar në përdorim të shoqërisë █████ sha (pika 1 e VKM nr. 864), e cila mbetet pronë publike e shtetit dhe regjistrohet në përgjegjësinë administrative të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (pika 4 e VKM nr. 864).

Shoqëria “█████” sha, për këtë sipërfaqe nuk ka kryer në Bashkinë Fushë Arrëz pagesën në vlerën **57,693,074 lekë**, sipas raportit teknik të paraqitur për shfrytëzimin e sipërfaqes së sipërpërmendur (shkresa nr. 481, datë 28.08.2013), veprim në kundërshtim me pikën 11, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor” dhe pikës 2, të VKM nr. 864, datë 10.12.2014.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI), të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar vlerën e detyrimit të pa derdhur në vlerën **57,693,074 lekë**, ndaj shoqëria █████.”.

Brenda muajit Gusht 2016

2. Gjetje nga auditimi: Taksa e ndikimit në infrastrukturë për objektin me leje zhvillimore/ndërtimi nr. 727, datë 29.10.2013, të investitorit “█████” 2 kat “Pikë Karburanti + Autogaz + Lavzh + Gomisteri”, nuk është llogaritur saktë për vlerën **1,413 lekë**. Gjithashtu nuk janë llogaritur punimet e kryera për vendosjen e depozitave të karburantit nëntokë natyrale në vlerën **7,088 lekë**.

2.1. Rekomandimi: Zyra e Planifikim e Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës prej **8,501 lekë**, ndaj subjektit **K.Q.**

Brenda muajit Shtator 2016

3. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Blerim ka lidhur kontratë nr. 491rep / 193kol, datë 07.04.2010 me shoqërinë “█████” sh.a me Nipt K92118019L përfaqësuar nga z. R.K. me afat 35 vjeçar, për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore prej 1400 m², me objekt; “dhënie në përdorim një sipërfaqe toke pyjore 1400 m², për ndërtim e HEC-ve në Lumin Dardhë – Pukë”. Tarifa e qirasë nuk është llogaritur sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", lidhja 2/11, duke evidentuar qira të pa llogaritur në vlerën **679,443 lekë**.

Me datë 03.07.2014 është bërë amendimi me kontratën shtesë nr. 610rep / 209/2kol, me objekt; “amendament kontratë shtesë në zbatim të kontratës së lidhur mes palëve datë 491rep/193kol, për dhënie në përdorim një sipërfaqe tokë pyjore shtesë prej 48 m², për ndërtim shtyllë të linjës 110 kv të HEC në Lumin Dardhë-Pukë”, duke evidentuar qira të pa llogaritur në vlerën **1,373 lekë**.

3.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Blerim, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin e vlerës **680,816 lekë**, ndaj shoqërisë “█████”.

Brenda muajit Gusht 2016

4. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të pasqyrës së realizimit të të ardhura për vitet 2013 - 2015, u konstatua se megjithëse janë planifikuar të ardhura nga taksa e zënies së hapësirës publike, nuk janë kryer kontrole dhe arkëtuar të ardhura nga shfrytëzimi i këtyre hapësirave, veprime në kundërshtim me nenet 4, 26 dhe 32, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzim nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurën Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Referuar të dhënave të regjistrit të pronave, miratuar me VKM nr. 337, datë 27.03.2008 dhe VKM nr. 1176, datë 20.08.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkisë Fushë Arrëz, Qarku Shkodër”, u konstatua se ka sipërfaqe të gjelbëruara prej 3910 m² (lloji lulishte), ku sipas të dhënave të zyrës së shërbimeve sipërfaqja prej 878 m² lulishte (*hapësirë publike*) është zënë me rrethim nga subjekti **Gj.Q.** me aktivitet “bar-kafe-hotel”, për të cilën nuk është kryer asnjë pagesë për taksën e zënies së hapësirës publike.

Nga përllogaritjet e bëra nga grupi i auditimit të KLSH, taksa e hapësirës publike e pa llogaritur paraqitet në vlerën **553,140 lekë**.

Gjithashtu, sipërfaqe të gjelbëruar prej 110 m² (hapësirë publike), ka zënë dhe subjekti “*P.N*” me aktivitet “bar-kafe”, për të cilën nuk janë llogaritur dhe arkëtuar detyrime për taksën e hapësirave publike në vlerën **69,300 lekë**.

4.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të kryejnë kontrole në të gjitha subjektet që shfrytëzojnë hapësira publike, duke dokumentuar punën me dokumentacion ligjor në llogaritjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga këto hapësira.

4.2. Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e Shërbimeve Publike, të marrë masa për evidentimin, saktësimin e sipërfaqes së zënies të hapësirës publike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **622,440 lekë**, *respektivisht subjektet*; “**Gj.Q**” me aktivitet “bar-kafe-hotel”, për vlerën **553,140 lekë** dhe “**P.N**” me aktivitet “bar-kafe”, për vlerën **69,300 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

5. Gjetje nga auditimi: Nga përpunimi i të dhënave në format elektronik, u konstatua se **52 subjekteve** nuk u janë planifikuar taksa e tarifa vendore në vitit pasardhës, duke mos bërë të mundur planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave në vlerën **749,120 lekë**, nga e cila: viti 2014 në vlerën 192,100 lekë dhe viti 2015 në vlerën 557,020 lekë, veprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar dhe nenit 112, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin, saktësimin e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **749,120 lekë ndaj 52 subjekteve**.

Brenda muajit Shtator 2016

6. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Blerim, u konstatua se ushtrojnë aktivitet 2 subjekte të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat e tarifave vendore në vlerën **63,500 lekë**, *respektivisht subjektet*; “**N.U**” me aktivitet “bar-restorant-hotel” në vlerën **46,000 lekë** dhe “**N.J.**” në vlerën **17,500 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 12 dhe 14, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar.

6.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Blerim, të marrë masa për evidentimin, saktësimin e

detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **63,500 lekë**, *respektivisht*:

-Subjekti “N.U” me aktivitet “bar-kafe”, për vlerën **46,000 lekë**;

-Subjekti “N.J” me aktivitet “transport udhëtarësh”, për vlerën **17,500 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

7. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Qafë Mali, u konstatua se për periudhën e viteve 2014 - 2015, janë lëshuar **41 leje transporti**, por që nuk është përlogaritur detyrimi për taksën e tonazhit në vlerën **269,995 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 30 (aneksi 4), të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar.

7.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Qafë Mali, të marrë masa për evidentimin, saktësimin e detyrimeve të subjekteve që ushtrojnë aktivitet, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **269,995 lekë në 41 subjekte**.

Brenda muajit Shtator 2016

8. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Blerim, u konstatua se sipas regjistrit të pronave dhe hartës (VKM nr. 801, datë 04.06.2008), në pasurinë nr. 135/a me sipërfaqe 9.5 ha (lloj “pyll”), është ndërtuar një objekt me destinacion “bar-restorant dhe hoteleri”.

Nga grupi i auditimit të KLSH, u kërkua dokumentacion mbi pronësinë e truallit në të cilën është ndërtuar objekti, nga ku rezultoi se sipërfaqja prej 1000 m² (e llojit arë), ZK 1444, nr.pasuri 239/4, vol 2 fq 50, kufizuar me pasurinë 239/3 në veri, lindje, jug dhe perëndim është në pronë të vetëpronarit, sipas certifikatës (vërtetim pronësie) nr.seri 831473 dhe nr. 847, datë 18.03.2015. Ky objekt është pa leje ndërtimi dhe nuk ka asnjë informacion nëse është në proces legalizimi ose jo, veprim në kundërshtim me nenin 14, të ligjit nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 502, datë 13.07.2011 “Për miratimin e rregullores të kontrollit të zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Nga ish-Komuna Blerim, nuk janë kryer kontrole në drejtim të sipërfaqes që zotëron subjekti nëse është më e madhe se sipërfaqja që ka me certifikatë pronësie, të procedurës që ka ndjekur ose po ndjek për objektin e ndërtuar, si dhe të detyrimeve për taksat e tarifat vendore të periudhës objekt auditimi, duke evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **182,310 lekë**, nga e cila; taksë ndërtese 121,200 lekë, taksë reklame 60,750 lekë dhe taksë table 360 lekë.

8.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Blerim dhe Drejtorinë e Shërbimit Pyjorë Fushë Arrëz, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialist të fushës, për evidentimin e sipërfaqes së zënë nga subjekti “████████”, nëse përpunet me sipërfaqen e certifikatë në pronës dhe **nëse jo për pjesën e sipërfaqen së shfrytëzueshme** (sipas ngastrave), të kërkohet detyrimi për qiranë në zbatim të dispozitave të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

8.2. Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Blerim, të marrë masa për evidentimin, saktësimin e detyrimit të subjektit “████████”, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **182,310 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

9. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Qafë Mali, janë lidhur **5 kontrata** për dhënie me qira të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore.

Në këto kontrata konstatohet se tarifa e qirasë nuk është në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, lidhja 2 dhe se detyrimet për qiranë nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke evidentuar një **dëm ekonomik në vlerën 4,560,227 lekë, nga e cila; mos llogaritje saktë e detyrimit në vlerën 1,519,000 lekë, mos derdhje e vlerës së detyrimeve të konstatuara në vlerën 2,878,252 lekë dhe mos aplikim të kamatëvonesave në vlerën 237,775 lekë, respektivisht kontratat;**

- nr. s’ka, datë 12.01.2011 me shoqërinë “██████████” sh.p.k, me përfaqësues ligjor z. P.B, për sipërfaqen 0.44 ha me vlerë **276,450 lekë, nga e cila; qira e pa llogaritur në vlerën 244,200 lekë, detyrim i pa derdhur prej 21,500 lekë dhe kamat vonesat nga mos likuidimi në afat i detyrimit prej 10,750 lekë.**

- nr. s’ka, datë 01.08.2013 me shoqërinë “██████████” me përfaqësues ligjor z. R.B, për sipërfaqen 0.4 ha me vlerë **39,977 lekë, nga e cila; detyrim i pa derdhur në vlerën 30,752 lekë dhe kamat vonesat nga mos likuidimi në afat i detyrimit në vlerën 9,225 lekë.**

-nr. s’ka, datë 04.03.2013 me shoqërinë “██████████” sh.p.k, me përfaqësues ligjor z. M.B, për detyrimin e pa derdhur prej 726,000 lekë dhe kamat vonesat nga mos likuidimi në afat i detyrimit prej 217,800 lekë, **gjithsej 943,800 lekë.**

- nr. s’ka, datë 25.09.2009 me shoqërinë “██████████” sh.a me përfaqësues ligjor D.T, për sipërfaqen 0.02 ha me vlerë **1,200,000 lekë, detyrim i pa llogaritur.**

-nr. 2851rep/937kol, datë 28.05.2009 me shoqërinë “██████████” sh.a me përfaqësues ligjor Ch.B, për sipërfaqen 0.03 ha me vlerë **2,100,000 lekë.**

9.1. Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Qafë Mali, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **4,633,027 lekë, respektivisht subjektet:**

-“██████████” sh.p.k për mos llogaritje detyrimi në vlerën **276,450 lekë;**

-“██████████” për mos likuidim detyrimi në vlerën **39,977 lekë;**

-“██████████” dhe “██████████” për mos likuidim detyrimi në vlerën **943,800 lekë;**

-“██████████” sha për mos llogaritje detyrimi në vlerën **1,200,000 lekë;**

-“██████████” sh.a për mos likuidim detyrimi në vlerën **2,100,000 lekë.**

Brenda muajit Shtator 2016

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të kontratës nr. 8, datë 24.11.2015 me objekt “Blerje dru zjarri për vitin 2015” të Bashkisë Fushë Arrëz, u konstatua se është zbatuar 7 ditë me vonesë, për të cilën nuk janë mbajtur kamat vonesat në vlerën **84,000 lekë, ndaj subjektit “██████████” shpk, veprim në kundërshtim me nenet 5 dhe 7, të kontratës.**

10.1 Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **84,000 lekë, nga subjekti “██████████” shpk.**

Brenda muajit Shtator 2016

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi përdorimin e karburantit në ish-Komunën Fierzë, u konstatua se dokumentacioni ligjor që shoqëron përdorimin e karburantit (fletudhëtimet), nuk justifikon sasinë e karburantit të tërhequr dhe shpenzuar prej **1988 litra me vlerë 349,872 lekë, veprim në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik, në kundërshtim me paragrafin III, germa (a, b, c) e pikës 35, pikat 36, 37, 38 e 39, 42, 43, germa “a” e pikës 44, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.**

11.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Fierzë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme

administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **349,872 lekë**, nga personat përgjegjës;

-z. S.M. me detyrë ish-shofer për vlerën **116,624 lekë**;

-z. B.J. me detyrë ish-magaziniere për vlerën **116,624 lekë**;

-z. I.A. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës për vlerën **116,624 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

12. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të shpenzimeve të kryera për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit në Bashkinë Fushë Arrëz dhe ish-Komunën Qafë Mali, u konstatuan veprime në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.10.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, kapitulli i III-të, pika 1, 3, germa “b” dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi janë bërë likuidime pa dokumentacion ligjor, me **dëm ekonomik në vlerën 266,000 lekë**.

12.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Qafë Mali, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **266,000 lekë**, nga personat përgjegjës: **Gj.N.** për vlerën **22,500 lekë**, **B.P.** për vlerën **7,500 lekë**, **Gj.K.** për vlerën **7,500 lekë**, **I.N.** për vlerën **22,500 lekë**, **H.K.** për vlerën **67,500 lekë**, **T.N.** për vlerën **20,000 lekë**, **P.N.** për vlerën **10,000 lekë**, **K.Ll.** për vlerën **10,000 lekë**, **D.P.** për vlerën **17,500 lekë**, **P.M.** për vlerën **35,000 lekë**, **E.E.** për vlerën **3,500 lekë**, **F.P.** për vlerën **15,000 lekë**, **E.M.** për vlerën **12,500 lekë**, **N.Gj.** për vlerën **7,500 lekë**, **T.Ll.** për vlerën **5,000 lekë** dhe **P.A.** për vlerën **2,500 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të kontratës nr. 201 datë 26.08.2013 me objekt “*Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë*” të ish-Komunës Fierzë, operatori ekonomik “**██████**” shpk, ka ofertuar më pak se preventivi i hedhur në tender.

Subjekti ka ofertuar për artikullin mbjellje fidanësh me të njëjtat karakteristika dy çmime të ndryshme, duke shkaktuar dëmi ekonomik prej **117,775 lekë**, nga ofertimi më shumë për prashitje tre herë me dëm ekonomik prej **39,514 lekë**, si dhe nga efekti i llogaritjes 10% për zëvendësime me dëm ekonomik në vlerën **398,925 lekë**.

13.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Fierzë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për mos likuidimin e vlerës **556,214 lekë pa tvsh dhe 667,457 lekë me tvsh**, për punimet e pa kryera nga kontraktuesi “**██████**” shpk.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt “*Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi*” të ish-Komunës Fierzë, fituar nga OE “**██████**” shpk me vlerë 23,855,232 lekë, u konstatua se: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO), në vlerësimin e ofertave ka vepruar me dy standarde, duke s’kualifikuar OE me vlerë më të ulët dhe duke kualifikuar si të rregullt OE me vlerë më të lartë, në kushtet kur edhe operatori fitues nuk i plotëson kriteret e kualifikimit, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me pasojë dëm ekonomik në vlerën **2,733,364 lekë**.

14.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Fierzë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e dëmit në vlerën **2,733,364 lekë**, nga personat përgjegjës;

-z. I.A. në pozicionin ish-Kryetar i KVO për vlerën **911,122 lekë**;

-z. P.P. në pozicionin ish-anëtarë i KVO për vlerën **911,122 lekë**;

-z. N.M. në pozicionin ish-anëtarë i KVO për vlerën **911,122 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në tenderin me objekt “*Ujësjetësi Kash – Qendër Berishë e Vogël*” të ish-Komunës Iball, fituar nga OE “██████” shpk me vlerë 3,431,439 lekë, u konstatua se KVO dhe NJHDT nuk kanë kërkuar konfiskimin e sigurimit të ofertës të OE “██████” shpk në vlerën **69,121 lekë**, pasi OE është tërhequr nga konkurrimi pa argument.

15.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Iballë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **69,121 lekë** (sigurim i ofertës), nga operatori ekonomik “██████” shpk.

Brenda muajit Shtator 2016

16. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogël në Bashkinë Fushë Arrëz me objekt “*Rubrike televizive, viti 2014*” në vlerën 119,500 lekë, nuk ka asnjë identifikim të nevojave për kryerjen e këtij shpenzimi, si dhe nuk ka argumentim të fondit limit. Kontrata datë 14.08.2014 e lidhur midis palëve, nuk ka bashkëlidhur preventivin me zëra konkretë të punës që do të kryhen.

Në lidhje me këtë shpenzim është paraqitur fatura tatimore nr. 177, datë 15.12.2014. Për likuidimin e kësaj fature nuk ka monitorim të punës së kryer (*akt marrje në dorëzim*), nuk ka hyrje në magazinë të CD e realizuara, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, për vlerën e dëmit ekonomik prej **119,500 lekë**.

16.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **119,500 lekë**, nga personat përgjegjës;

-zj. P.P. në pozicionin ish-Kryetar i KBVV për vlerën **39,834 lekë**;

-znj. M.Ll. në pozicionin ish-anëtarë e KBVV për vlerën **39,833 lekë**;

-z. I.N. në pozicionin ish-anëtarë i KBVV për vlerën **39,833 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

17. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të procedurave të blerjeve me vlera të vogla me objekt “*Mirëmbajtje për kaldajën në shkollën Kryezi + shërbim e pastrim*” në ish-Komunën Qafë Mali, për zëra punimi si; furnizimi i kaldajës me dru dhe nderzja e saj (orë pune 600), shërbime pastrimi shkolla Kryezi (orë pune 800), mirëmbajtje kaldaje dhe shërbime të ndryshme (orë pune 80), u konstatua se nuk ka asnjë të dhënë se kujt periudhe kohore do t’i përkasin shërbimet e mirëmbajtjes, pasi është kryer në fund të vitit shkollorë (fatura tatimore nr. 12, datë 30.06.2015). Nuk ka asnjë të dhënë mbi zërin e punës “*Shërbime pastrimi shkolla Kryezi*”, nuk ka certifikatë të marrjes në dorëzim për punët e kryera, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 34, 35 dhe 36 e kreut III, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe pika 1, 3, 4, 5 dhe 7 e nenit 40, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me dëm ekonomik në vlerën **165,000 lekë**.

17.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Qafë Mali, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **165,000 lekë**, nga personat përgjegjës;

-z. P.M. me detyrë ish-p/zyrës së financës për vlerën **41,250 lekë**;

- z. **D.P.** në pozicionin Kryetar i NJHDT për vlerën **41,250 lekë**;
- znj. **E.E.** në pozicionin anëtarë i NJHDT për vlerën **41,250 lekë**;
- z. **P.A.** në pozicionin anëtarë i NJHDT për vlerën **41,250 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

18. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e zbatimit të procedurave të prokurimit për blerje me vlerë të vogël me objekt “Media lokale” në ish-Komunën Qafë Mali, nuk ka asnjë identifikim të nevojave për kryerjen e këtij shpenzimit, nuk ka argumentim të fondit limit, si dhe kërkesë së përse duhet bërë ky shpenzim, por vetëm një aktmarrëveshje pa datë midis palëve e cila parashikon pasqyrimin e veprimtarive të ndryshme sociale, kulturore, njoftime, intervista, deklarata për shtyp, etj. Për këtë shpenzim ka dalë urdhër prokurimi për BVV nr. 26, datë 15.06.2015, në një kohë që mbyllja e aktivitetit të Komunave do të bëhej më 07.07.2015.

Për likuidimin e kësaj fature nuk ka monitorim të punës së kryer (akt marrje në dorëzim), nuk ka hyrje në magazinë të CD së realizuara, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me **dëm ekonomik në vlerën 147,500 lekë**.

18.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Qafë Mali, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **147,500 lekë**, nga personat përgjegjës;

-z. **H.K.** në pozicionin ish-Titullari i AK për vlerën **73,750 lekë**.

-z. **P.M.** në pozicionin ish-përgjegjës i zyrës së financës për vlerën **73,750 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

19. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Iball, u konstatua se në 3 (tre) raste nuk janë mbajtur kamat vonesa për realizim me vonesë të punëve/mallrave, veprim në kundërshtim me kushtet e kontratave përkatëse, me **dëm ekonomik në vlerën 19,038 lekë**, si vijon: “Blerje dru zjarri të gatshme për stufe për shkollat e komunës”, realizuar me subjektin fizik **M.C.** në vlerën **6,900 lekë**, “Riparime të ndryshme në shkollat Iball”, realizuar me subjektin fizik **M.L.** në vlerën **7,256 lekë** dhe “Lyerje dhe sherbetisje e shkollave Iball”, realizuar me subjektin “**██████**” shpk në vlerën **4,882 lekë**.

19.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Iballë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **19,038 lekë**, ndajë subjekteve: “**M.C**” për vlerën **6,900 lekë**, “**M.L**” për vlerën **7,256 lekë** dhe **██████** shpk, për vlerën **4,882 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

20. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Fierzë, u konstatua se janë kryer shpenzime me objekt “Shërbime për kronika televizive”, për likuidimin e të cilës nuk ka asnjë argumentim për domosdoshmërinë e tij, nuk ka parashikim se çfarë do të bëhet, nuk ka llogaritje të fondit, nuk është bërë akt monitorimi për punën e kryer, si dhe nuk janë bërë hyrje në magazinë CD e programeve të transmetuara, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me **dëm ekonomik në vlerën 78,000 lekë**.

20.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Fierzë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **78,000 lekë**, nga personat përgjegjës;

-z. **I.A.** në pozicionin ish-Kryetarit të KBVV në vlerën **26,000 lekë**;

-z. **N.M.** në pozicionin e ish-anëtarit të KBVV në vlerën **26,000 lekë**;

-z. P.P. në pozicionin e ish-anëtarit të KBVV në vlerën **26,000 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

21. Gjetje nga auditimi: Këshilltarët e Bashkisë Fushë Arrëz dhe ish-Komunës Qafë Mali edhe pse nuk kanë marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak/Komunal janë paguar për vlerën **1,228,264 lekë**, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe pikën 69, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

21.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësinë Administrative Qafë Mali, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,228,264 lekë**, nga personat përgjegjës: **B.M.** për vlerën **19,915 lekë**, **F.M.** për vlerën **5,049 lekë**, **A.S.** për vlerën **11,979 lekë**, **M.G.** për vlerën **6,930 lekë**, **B.Q.** për vlerën **30,888 lekë**, **L.M.** për vlerën **66,988 lekë**, **A.S.** për vlerën **6,930 lekë**, **P.P.** për vlerën **17,028 lekë**, **A.D.** për vlerën **94,989 lekë**, **A.D.** për vlerën **85,616**, **O.Ç.** për vlerën **69,630 lekë**, **Z.N.** për vlerën **62,782 lekë**, **I.M.** për vlerën **59,895 lekë**, **P.Gj.** për vlerën **19,072 lekë**, **A.K.** për vlerën **14,304 lekë**, **M.M.** për vlerën **14,304 lekë**, **S.Gj.** për vlerën **19,072 lekë**, **D.C.** për vlerën **9,536 lekë**, **E.Ll.** për vlerën **4,768 lekë** dhe **N.B.** për vlerën **9,536 lekë**.

Ish-Këshilltarët e Komunës Qafë Mali: **A.D.** për vlerën **34,567 lekë**, **E.P.** për vlerën **108,980 lekë**, **E.Ll.** për vlerën **14,949 lekë**, **D.Ll.** për vlerën **34,765 lekë**, **F.A.** për vlerën **15,585 lekë**, **N.N.** për vlerën **64,398 lekë**, **K.Gj.** për vlerën **14,767 lekë**, **P.P.** për vlerën **118,880 lekë**, **P.L.** për vlerën **44,550 lekë**, **M.P.** për vlerën **98,882 lekë** dhe **J.D.** për vlerën **49,730 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

22. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të bankës, u konstatua se ish-Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz z. A.Q, ish-Kryetari i Komunës Fierzë z. V.M. dhe ish-Kryetari i Komunës Qafë Mali z. H.K. iu është paguar përfitimi financiar mujor i shërbimit të transportit në vlerën 30,000 lekë/muaj, veprim në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, i ndryshuar, me nenin 1, të ligjit nr. 169/2013 për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”, shpallur me dekretin nr. 8410, datë 27.11.2013, pasi masa e këtij shpërblimi nga muaj dhjetor 2013 e në vazhdim është hequr, veprime në shkelje të disiplinës financiare me **dëm ekonomik në vlerën 120,000 lekë**.

22.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **120,000 lekë**, nga personat përgjegjës;

-z. **A.Q.** me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz për vlerën **60,000 lekë**;

-z. **V.M.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Fierzë për vlerën **30,000 lekë**;

-z. **H.K.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Qafë Mali për vlerën **30,000 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

23. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fushë –Arrëz, në kundërshtim me nenin 8/1, të ligjit nr. 8438, datë 20.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në listë pagesat e muajit, mars, prill dhe qershor viti 2014, nuk është aplikuar tatim mbi të ardhura personale në masën 10 %, me një efekt financiar në dëm ekonomik në buxheti për vlerën **22,609 lekë**.

23.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **10,799 lekë**, nga personat përgjegjës;

-z. **Gj.N.** me detyrë ish-Nën/Kryetar për vlerën **8,340 lekë**;

-z. **I.N.** me detyrë ish-P/Zyrës së Financës për vlerën **1,229 lekë**;

-znj. **B.M.** me detyrë specialiste finance për vlerën **1,230 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

24. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të udhëzimit nr. 31, datë 29.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2, u konstatua se llogaritja dhe pagesa e tatimit në burim për anëtarët e Këshillit dhe Kryepelqët e fshatrave është bërë në masën 10% nga 15% të përfitimit mujor, me një efekt financiar në dëm ekonomik në buxhet për vlerën **24,821 lekë**, nga e cila; në ish-Komunën Qafë Mali për **21 përfitues me vlerë 12,721 lekë** dhe ish-Komunën Iballë për **22 përfitues në vlerën 12,100 lekë**.

24.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Qafë Mali dhe Iballë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **24,821 lekë**, nga personat përgjegjës, sipas aneksit 19 dhe 20, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Shtator 2016

25. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi përdorimin e karburantit për kaldajën e Bashkisë Fushë Arrëz (periudha 2013 – 2015), u konstatua se nuk ka dokumentacion justifikues mbi përdorimin e sasisë prej **2301 litra me vlerë 340,197 lekë**, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me paragrafin III pika 35 germa (a, b, c), pika 36, 37, 38 e 39, 42, 43, 44 germa a, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

25.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **340,197 lekë**, nga personat përgjegjës; **znj. F.K.** për vlerën **170,098 lekë** dhe **P.M.** për vlerën **170,098 lekë**, si persona me përgjegjësi materiale.

Brenda muajit Shtator 2016

26. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi përdorimin e karburantit nga kaldaja e kopshtit dhe e Bashkisë Fushë Arrëz (viti 2013), u konstatua se nuk ka dokumentacion justifikues mbi përdorimin e sasisë prej **466 litra në vlerën 86,676 lekë**, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me paragrafin III, germa (a, b, c) e pikës 35, pika 36, 37, 38 e 39, 42, 43, 44 germa a, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

26.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **86,676 lekë** nga **znj. M.B.** si personi me përgjegjësi materiale.

Brenda muajit Shtator 2016

27. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi përdorimin e karburantit në Bashkinë Fushë Arrëz dhe ish-Komunat Qafë Mali dhe Iballë, u konstatua se dokumentacioni ligjor që shoqëron përdorimin e karburantit (fletudhëtimet), nuk justifikon plotësisht sasinë e karburantit të tërhequr dhe shpenzuar prej **6522 litra me vlerë 1,181,769 lekë**, duke shkaktuar një efekt financiar negativ me dëm ekonomik, në kundërshtim me paragrafin III pika 35 germa (a, b, c), pika 36, 37, 38 e 39, 42, 43, 44 germa a, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

27.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Qafë Mali dhe Iballë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerën **1,181,769 lekë**, nga personat përgjegjës;

- z. **A.Q.** me detyrë ish-shofer administrate në Bashkinë Fushë Arrëz, për sasinë 3000 litra me vlerë **558,000 lekë**;
- z. **H.M.** me detyrë shofer administrate në Bashkinë Fushë Arrëz, për sasinë 1565 litra me vlerë **248,421 lekë**;
- z. **A.Sh.** me detyrë shofer i ish-shofer administrate në Komunën Iball, për sasinë 120 litra me vlerë **21,600 lekë**;
- z. **T.N.** me detyrë ish-shofer Administrate në Komunën Qafë Mali, për sasinë 745 litra me vlerë **133,208 lekë**;
- z. **P.N.** me detyrë ish-magaznier në Komunën Qafë Mali, për sasinë 1092 litra me vlerë **220,540 lekë**.

Brenda muajit Shtator 2016

28. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-Vjeçare “Shtjefën Gjeqovi” Kryezi”, ish-Komuna Qafë-Mali, nga dokumentacioni teknik i zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike dhe verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë **1,387,448 lekë** pa tvsh, nga e cila; vlera **1,029,748 lekë** pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera **357,700 lekë**, si pasojë e miratimit të zërave të rinj punimesh me efekte negative për buxhetin e ish-Komunës, veprime në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Qafë-Mali, Pukë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. L.B, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

28.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Qafë Mali, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,387,448 lekë pa tvsh, nga e cila; vlera 1,029,748 lekë** pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera **357,700 lekë** miratimin e zërave të rinj punimesh me efekte negative për buxhetin e ish-Komunës Qafë-Mali nga OE “XXXXXXXXXX” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve sipas kontratës nr. 03, datë 21.06.2013.

Brenda muajit Shtator 2016

29. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtimi i Shkollës 9-Vjeçare, Fshati Mëzi”, ish-Komuna Fierzë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen dhe verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë në vlerën **1,844,581 lekë pa tvsh** (dëm ekonomik), nga e cila; vlera **773,899 lekë pa tvsh** për punime të pakryera në fakt dhe vlera **1,070,682 lekë pa tvsh** për ndryshimi të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, veprime në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Fierzë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. L.B. neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

29.1. Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Njësitë Administrative Fierzë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,844,581 lekë** pa tvsh, nga të cilat; vlera **773,899 lekë** pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera **1,070,682 lekë** pa tvsh për ndryshimi të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës nga OE “██████████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësi të punimeve sipas kontratës nr. 221, datë 06.11.2014.

Brenda muajit Shtator 2016

C. MASA DISIPLINORE:

C/I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” germa “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe gerrat “g” dhe “k” e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë që t’i kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore,

-Nga “Mbajtja deri në 1/3 e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj” neni 58, germa “b”. Deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58, germa “c”, për 4 punonjësit si më poshtë:

1. Zj. P.P. me detyrë Juriste Bashkia Fushë Arrëz dhe në pozicionin e ish-Kryetarit të Komisionit të Blerjeve me Vlera të Vogla (KBVV), për;

-Mos zbatim të rekomandimeve të KLSH^{së} për dëmin ekonomik në vlerën **418,366 lekë**, në kundërshtim me nenet 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe pikën 93, e Kapitullit IV, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Mos zbatimin e procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogël (BVV), me objekt “Rubrike televizive, viti 2014”, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

2. Z. I.A. me detyrë specialist finance Njësia Administrative Fierzë, në pozicionin ish-P/Zyrës së Financës dhe ish-anëtar i KBVV në Komunën Fierzë, për:

-Kryerjen e pagesës së përfitimit financiar mujor të shërbimit të transportit, në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, i ndryshuar me nenin 1, të ligjit nr. 169/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”.

-Parregullsi të konstatuara në prokurimin me objekt “Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, të pika 9 e nenit 4, pika 3 e nenit 14, pika 3 e nenit 15 dhe pika 4 e nenit 16, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, si dhe VKM nr. 530, datë 13.06.2013 “Për përcaktimin e kritereve të tregtimit dhe të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve përveç farës”.

-Mos zbatim të procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogël (BVV), me objekt “Shërbime për kronika televizive”, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

3. Z. F.D. me detyrë specialist finance Njësia Administrative Blerim, në pozicionin e ish-P/Zyrës Financës Komuna Blerim dhe si anëtar i KBVV, për;

Mos zbatim të procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogël, me objekt “*Mirëmbajtje pajisje elektrike*”, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pikat 34, 35 dhe 36 e kreut III, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe pikat 1, 3, 4, 5 dhe 7 e nenit 40, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

4. Zj. E.E. me detyrë Përgjegjëse në Zyrën e Financës Bashkia Fushë Arrëz, në cilësinë e anëtarit të KBVV, Komuna Qafë Mali, për;

Mos zbatim të procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogël, me objekt; “*Mirëmbajtje për kaldajën në shkollën Kryezi + shërbim e pastrim*”, në ish-Komunën Qafë Mali, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pikat 34, 35 dhe 36 e kreut III, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe pikat 1, 3, 4, 5 dhe 7 e nenit 40, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

C/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe pikës 8 të kontratës individuale të punës, **i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë** që t’i kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, **të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 3 punonjësit si më poshtë:**

“Vërejtje me paralajmërim”, pika 8/2 e kontratës individuale.

1. Z. K.V. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit të KBVV, për:

Mos zbatim të procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogël, me objekt “*Mirëmbajtje pajisje elektrike*”, në kundërshtim me paragrafin III, germa (a, b, c) e pikës 35, pikat 36, 37, 38, 39, 42, 43, germa “a” e pikës 44, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2. Znj. F.K. me detyrë magazinierë në Bashkinë Fushë Arrëz, për;

Mos dokumentimin e përdorimit të karburantit në sasinë **2301 litra me vlerë 340,197 lekë**, në kundërshtim me paragrafin III, germa (a, b, c) e pikës 35, pikat 36, 37, 38, 39, 42, 43, germa “a” e pikës 44, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

3. Z. B.J. me detyrë Inspektor i Taksave Vendore Njësia Administrative Fierzë, në pozicionin e ish-magazinerit të Komunës Fierzë, për:

-Mos dokumentimin e përdorimit të karburantit në sasinë **1988 litra me vlerë 349,872 lekë**, në kundërshtim me paragrafin III, germa (a, b, c) e pikës 35, pikat 36, 37, 38, 39, 42, 43, germa “a” e pikës 44, 47 dhe 48, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011” Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

D/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike të neneve 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 13, datë 27.05.2016, vërejtjet dhe komentet e subjektit të audituar në pjesën e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe geramat (c dhe ç) e nenit 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **8 punonjës të ish-Komunës Fierzë**, si më poshtë:

1. z. D.M. me detyrë juristi i jashtëm, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në 2 tendera me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi Komuna Fierzë -Pukë” dhe “Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë”.

2. z. S.M. me detyrë Administrator Komuna Fierzë, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në tenderin me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi Komuna Fierzë -Pukë”.

3. z. A.D. me detyrë Nëpunës i Gjendjes Civile Komuna Fierzë, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në tenderin me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi Komuna Fierzë -Pukë”.

4. z. E.A. me detyrë ekonomist i jashtëm, në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në tenderin me objekt “Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë”.

5. z. I.A. me detyrë specialist finance Njësia Administrative Fierzë, në cilësinë e **kryetarit të KVO^{së}**, në tenderin me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi Komuna Fierzë -Pukë” dhe anëtar i KVO në tenderin me objekt “Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë”.

6. z. P.P. me detyrë ish-Përgjegjës Shërbimesh Komuna Fierzë, në cilësinë e anëtarit të KVO^{së}, në tenderin me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi Komuna Fierzë -Pukë” dhe “Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë”.

7. z. N.M. me detyrë ish-Sekretar Komuna Fierzë, në cilësinë e anëtarit të KVO^{së}, në tenderin me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi Komuna Fierzë -Pukë” “Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë”.

8. z. L.S. me detyrë Inspektor i Ndihmës Ekonomike Komuna Fierzë, në cilësinë e anëtarit të KVO^{së}, në tenderin me objekt “Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë”.

Më hollësisht për dy procedurat sa më poshtë vijon:

a -Në tenderin e zhvilluar në ish-Komunën Fierzë në vitin 2014, me objekt “Ndërtim i shkollës 9 vjeçare Fshati Mzi Komuna Fierzë-Pukë”, me urdhër prokurimi nr. s`ka datë 03.09.2014 dhe fondin limit 24.189.056 lekë (*procedurë e hapur*), ku kanë marrë pjesë 2 OE dhe është s`kualifikuar 1 (një). Fitues është shpallur subjekti “██████████ sh.p.k, me vlerë 23,855,232 lekë (pa tvsh) dhe diferencë nga fondi limit 333,824 lekë, nga ku rezultoi se:

-Dosja e procedurës e gjendur në arkivin e Bashkisë Fushë Arrëz, nuk është inventarizuar dhe arkivuar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij.

-Dokumentet e tenderit nuk janë të firmosura nga NJHDT, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2/a, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”.

-Në DT është kërkuar që OE të paraqesë licensë profesionale të shoqërisë për nivele të kategorisë së licencës për punime ndërtimi lidhur me ekzekutimin e kontratës më të larta se volumet e punimeve të vetë objektit, veprim në kundërshtim me nenet 8 dhe 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

-Janë kërkuar kategori license: NP12 A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”, si dhe kategoritë NS14 A “Impiante të brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV” dhe NS14 A “Impiante të brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV etj”, në një kohë që asnjë nga zërat e preventivit nuk kanë të tilla punime.

-Në DT është kërkuar që OE, duhet të disponojë një punësim mesatar për periudhën Janar 2013 - Korrik 2014, prej të paktën 100 punonjës, i pa argumentuar me volume pune dhe grafik punimesh.

- Në DT, në pikën 2.2/e “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, është kërkuar që OE të paraqesë: “Vërtetim nga njësia vendore ku do të ndërtohet objekti (Komuna Fierzë-Puke) se OE nuk ka detyrime financiare kundrejt kësaj njësie (Në rastet e Bashkimit të operatorëve ekonomike, ky vërtetim duhet të paraqitet nga secili pjesëtar i bashkimit)”.

Sa më sipër vendosja e kësaj kërkesë është në kundërshtim me kërkesat e LPP, pasi sipas QKR vërtetime për likuidim e taksave vendore, duhet të paraqiten për vendet ku ushtron aktivitetin (subjekti është i regjistruar) dhe NJHDT mund të kishte vendosur kërkesën që OE pjesën e Bashkisë Fushë Arrëz nuk duhet të jetë debitor pranë kësaj komune.

-Në DT në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, është kërkuar që të paraqitet “Xhiroja vjetore e secilit për tre vitet e fundit (2011, 2012 dhe 2013), si dhe në vitin 2014 duhet të ketë një vlerë jo më e ulët se vlera e fondit limit”, duke mos përcaktuar se për çfarë periudhe kohore duhet të jetë xhiro e vitit 2014.

Sa më sipër për përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, geramat (c, ç dhe d), neni 2-“Parimet e përzgjedhjes” geramat (a, b dhe c) dhe neni 20-“Mosdiskriminimi”,

- Nga auditimi i zbatimit të procedurës (vlerësimi i ofertave) është s`kualifikuar OE me vlerë më të ulët, pasi nuk plotëson kriteret e veçanta për kualifikim, në një kohë që është kualifikuar (shpallur fitues) dhe lidhur kontrata me OE “XXXXXXXXXX” sh.p.k.

Nga auditimi i ofertës fituese “XXXXXXXXXX” sh.p.k, rezultoi se nuk plotëson kërkesën për punësim mesatar (periudha Janar 2013-Korrik 2014), i të paktën 100 punonjësve, pasi në listë pagesat mujore nuk plotësohet numri i punonjësve të kërkuar, ku evidentohen punonjës me profesion shofer autobusi e furgoni, policë ruajtje objekti, fatorino, kamerier, shitës dhe teknik të pasjeve elektronike, shitës karburanti, etj. Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë (ISO 9001), nuk është e përkthyer dhe noterizuar dhe në 5 raste ka paraqitur dokumentacion fotokopje apo me datë noterizimi tre muaj më parë nga data e hapjes së tenderit.

Sa më sipër, KVO-ja ka s`kualifikuar OE me vlerë më të ulët duke përdorur dy standarde në klasifikimin e OE, veprim në kundërshtim me geramat (c, ç dhe d) të pikës 2 e nenit neni 1 dhe geramat (a, b dhe c) e nenit 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke shkaktuar pabarazi dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e në shumën **2,733,364 lekë**.

b- Në tenderin e zhvilluar në ish-Komunën Fierzë (viti 2013), me objekt “*Pyllëzim me dru frutorë në Komunën Fierzë*”, me urdhër prokurimi nr. 182 datë 10.07.2013, me fondin limit 5.685.720 lekë (*procedura e hapur*), merr pjesë 1 (një) OE “█████ sh.p.k, i cili është shpallur fitues me vlerë 5,651,561 lekë (pa tvsh) dhe diferencë nga fondi limit 34,159 lekë, nga ku rezultoi se:

-Dosja e procedurës e gjendur në arkivin e Bashkisë Fushë Arrëz, nuk është inventarizuar dhe arkivuar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij.

-Dokumentet e tenderit nuk janë të firmosura nga NJHDT, veprim në kundërshtim me kreu V- “Zhvillimi i procedurave”, pika 2/a- “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Urdhri i prokurimit ka përcaktuar si formë prokurimi “Tender i hapur”, ndërkohë në procesverbalin e miratimit të DT (hartuar nga NJHDT) dhe në sistemin e app.gov.al është përcaktuar procedura “Kërkesë për propozim”.

-Në DT (kërkesat e veçanta teknike për kualifikim), nuk është kërkuar asnjë dokumentacion në lidhje me paraqitjen e certifikimit zyrtar të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të prodhuar në vend (certifikata e origjinës), i cili të vërtetojë pastërtinë gjenetike të varietetit. Certifikata fitosanitare lëshuar nga shërbimi fitosanitar; akaprobimi fushor; fletanaliza laboratorike e treguesve cilësorë për çdo varietet dhe lot që certifikohet lëshuar nga laborator i miratuar nga ministri; etiketa e prodhuesit; deklarata e konformitetit, në zbatim të neneve 4, pika 9, neni 14 pika 3, neni 15 pika 3, dhe neni 16 pika 4, të ligjit nr. 10416, datë 07.04.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, si dhe VKM nr. 530, datë 13.06.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialit mbjellës dhe shumëzues të perimeve përveç farës”.

-Dokumentet e tenderit janë të paqarta në drejtim të kërkesave të numrit të punonjësve.

-KVO ka klasifikuar dhe shpallur fitues OE “█████” sh.p.k, në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur likuidimin e taksave vendore, sipas adresave të përcaktuara në ekstraktin historik të shoqërisë, por ka paraqitur vetëm nga Komuna Iballë Pukë.

- Nga krahasimi i preventivit të Dokumenteve të tenderit me ofertën e paraqitur, rezulton se OE “█████” sh.p.k, për pyllëzimin me fidanë gështenje për sipërfaqen 17 ha në ekonominë pyjore Iballë Mëzi (pjesa ekonomike Mëzi), parcela nr. 18/b ka ofertuar më pak se sa preventivi i hedhur në tender duke mos plotësuar sasinë e kërkuar në DT, me efekt **667,457 lekë** me tvsh.

D/2. Për Bashkinë Fushë Arrëz.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenet 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në proces verbalet nr. 19 dhe 20 datë 27.05.2016 komentet e subjektit të audituar dhe pjesës takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pika IV/6.1 faqe 88-100.

Duke qenë se Bashkia Fushë-Arrëz, nuk ka krijuar strukturën e IMTV, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ndryshuar me nenin 12, të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandoj, Bashkisë Fushë Arrëz** që t’i dërgojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjorbë, për mbikëqyrësin dhe kolaudatorit e punimeve, si më poshtë:**

1. z. L.B., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në 2 objekte, si më poshtë:

-Miratimin e zërave të rinj të punimeve në objektin: “Rikonstruksion Shkolla 9-Vjeçare “Shtjefën Gjeqovi” Kryezi”, ish-Komuna Qafë-Mali, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **1,387,448 lekë** pa tvsh.

-Nga mos kontrolli i punimeve në objektin: “Ndërtimi i Shkollës 9-Vjeçare, Fshati Mëzi”, ish-Komuna Fierzë, ka situacionuar dhe kolauduar punime të pakryera me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **1,844,581 lekë** pa tvsh.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

2. z. T.S., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara, si më poshtë:

-Miratimin e zërave të rinj të punimeve në objektin: “Rikonstruksion Shkolla 9-Vjeçare “Shtjefën Gjeqovi” Kryezi”, ish-Komuna Qafë-Mali, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **1,387,448 lekë** pa tvsh.

Veprime këto në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar si dhe me Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3.

Brenda muajt Gusht 2016

Shënim:

Për **17 ish-punonjësit** e mëposhtëm, masa disiplinore për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Bashkinë Fushë Arrëz dhe 4 Njësitë Administrative (Qafë Mali, Blerim, Fierzë dhe Iballë), pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim.

1. z. V.M. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Fierzë.
2. z. H.K. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Qaf Mali.
3. z. A.P. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Qafë Mali.
4. z. G.V. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Iball.
5. z. N.P. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Blerim.
6. z. V.M. me detyrë ish-Kryetar i Komunës Fierzë.
7. z. I.N. me detyrë ish-P/Zyrës së Financës në Bashkinë Fushë Arrëz.
8. z. N.L. me detyrë ish-Specialist në Zyrën e Urbanistikës në Bashkinë Fushë Arrëz.
9. znj. O.G. me detyrë ish-Specialist në Zyrën e Urbanistikës në Bashkinë Fushë Arrëz.
10. z. K.P. me detyrë ish-Ins/Taksave Vendore në Bashkinë Fushë Arrëz.
11. z. P.M. me detyrë ish-P/Zyrës së Financës në ish-Komunën Qafë Mali.
12. z. S.D. me detyrë ish-P/Zyrës së Financës në ish-Komunën Iball.
13. z. T.P. me detyrë ish-Inspektor Pyjesh në ish-Komunën Blerim.
14. z. K.Ll. me detyrë ish-Inspektor i taksave në Komunën Qafë Mali.
15. z. T.L. me detyrë ish-Specialist i Pyjeve.
16. z. J.N. me detyrë ish-Specialist Bujqësie, në cilësinë e anëtarit të KVO.
17. z. P.M. me detyrë ish-furnitor në Bashkinë Fushë Arrëz.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Fushë Arrëz (Sektor i Administrimit të burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R